

**Këtu do të gjeni përgjigje për disa nga pyetjet më të zakonshme, por, më gjerësisht mund të njiheni në Ligj, Rregullore dhe dokumentet strategjike.**

### **1. Pyetje: Çfarë është nënshkrimi elektronik?**

Përgjigje: Një nënshkrim elektronik është një mjet verifikimi elektronik. Ky term zakonisht përcaktohet si verifikim i identitetit të zotëruesit dhe të dhënave të nënshkruara. Duke ju referuar ligjit, “Nënshkrim elektronik” janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar.

### **2. Pyetje: Cilat janë llojet e nënshkrimit elektronik?**

Përgjigje: Ligji shqiptar flet për nënshkrim elektronik të avancuar dhe nënshkrim elektronik të kualifikuar. Nënshkrimet elektronike të avancuara, janë nënshkrimet elektronike të cilat:

- i jepen ekskluzivisht një zotëruesi specifik të kodit të nënshkrimit;
- mundësojnë identifikimin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit;
- prodhohen me mjete të sigurta, që mund të mbahen nën kontrollin vetëm nga zotëruesi i kodit të nënshkrimit lidhen me të dhënat, në mënyrë të tillë që të mundësojnë dallimin lehtësisht të çdo ndryshimi të mëparshëm të këtyre të dhënave.

Nënshkrimi elektronik i kualifikuar është nënshkrimi elektronik i avancuar, i cili:

- mbështetet në një certifikatë të kualifikuar;
- prodhohet me mjet të sigurtë për krijimin e nënshkrimeve.

### **3. Pyetje: Çfarë janë certifikatat e kualifikuara?**

Përgjigje: Certifikatat e kualifikuara janë certifikata të lëshuara nga Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit. Certifikatat janë publike dhe mund të gjenden në faqen zyrtare të çdo Ofruesi të Shërbimit të Certifikimit. Certifikatat elektronike shërbejnë kryesisht për të siguruar:

- *Identifikimin* e dërguesit/marrësit dhe informacionit të nisur;
- *Privatësinë*, informacioni i dërguar do të shikohet vetëm nga personat e autorizuar;
- *Enkriptimin*, informacioni nuk mund të deshifrohet nga personat e paautorizuar;
- *Nënshkrimin elektronik*, që siguron paprekshmërinë e mesazhit dhe konfirmimin e marrjes/dërgimit të dhënave elektronike.

Një tjetër vlerë e përdorimit të certifikatave elektronike është se, kompanitë hosting nuk kanë nevojë të mbajnë dhe ruajnë fjalëkalimet (passwords) e klientëve, por njohin certifikuesit e besueshëm, të cilët do të luajnë atë rol.

### **4. Pyetje: Cila është vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike?**

Përgjigje: Dokumenti elektronik, i cili përmban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.

### **5. Çfarë të dhënash duhet të përmbajë një certifikatë e kualifikuar?**

- a) emrin e zotëruesit të kodit të nënshkrimit;

- b) kodin e caktuar për testimin e nënshkrimit;
- c) caktimin e algoritmeve, me të cilat mund të përdoret kodi i testimit të nënshkrimit;
- ç) numrin përkatës të certifikatës;
- d) afatin e vlefshmërisë;
- dh) emrin e ofruesit të shërbimit të certifikimit dhe shtetin ku është i regjistruar;
- e) informacionin, nëse përdorimi i kodit të nënshkrimit është i kufizuar vetëm për disa përdorime, sipas natyrës ose shtrirjes;
- ë) informacionin, që certifikata është e kualifikuar;
- f) nëse është e nevojshme, cilësitë e veçanta të zotëruesit të kodit të nënshkrimit.

## **6. Pyetje: Cili është roli i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik?**

Përgjigje: Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, (AKCE) është institucioni që mbikëqyr zbatimin e ligjit Nr. 9880, dt. 25.02.2008, “Për Nënshkrimin Elektronik” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Autoriteti regjistron ofruesin e shërbimit certifikimit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tij. AKCE ka të drejtë të inspektojë apo të kërkojë informacion në mënyrë periodike nga ofruesit e shërbimeve sa herë që gjykon ai të arsyeshme, gjithashtu autoriteti urdhëron shfuqizimin e certifikatave të kualifikuara. AKCE ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të certifikimit.

## **7. Pyetje: Ku duhet të drejtohem për të zotëruar një nënshkrim elektronik?**

Përgjigje: Nënshkrimet elektronike të kualifikuara dhe certifikatat e kualifikuara lëshohen nga Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit të regjistruar pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE). Një listë e Ofruesve të Shërbimit të Certifikimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, [www.akce.gov.al](http://www.akce.gov.al).

## **8. Pyetje: Çfarë janë Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit?**

Përgjigje: Ofruesit e Shërbimit të Certifikimit, janë persona juridikë ose fizikë, të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara ose vula kohore të kualifikuara, e për ketë janë miratuar nga autoriteti kompetent.

## **9. Pyetje: Çfarë është Vula Kohore e kualifikuar?**

Përgjigje: Është një mjet, i cili nuk verifikon vërtetësinë e dokumentit, por konfirmon se të dhënat elektronike janë paraqitur në një kohë të caktuar.

## **10. Pyetje: Çfarë janë pajisjet e sigurta për krijimin e nënshkrimit?**

Përgjigje: Pajisjet e sigurta për krijimin e nënshkrimit elektronik, mund të jenë Smart Card, ose hardware token. Smart Card mund të lidhen me pajisjet kompjuterike me anë të lexuesve të posaçëm, ndërsa hardware token mund të jenë Flash Memory, të cilat lidhen me anë të portave normale USB. Ato përmbajnë kodin e nënshkrimit, i cili shërben për krijimin e nënshkrimit dhe të certifikatës së kualifikuar.

## **11. Pyetje: Në çfarë rastesh mund të përdoret nënshkrimi elektronik?**

Përgjigje: Nënshkrimi elektronik mund të përdoret si mjet i vërtetimit të të dhënave në çdo komunikim elektronik. Mund të përdoret në çdo dokument elektronik, e-mail, prokurime online, nënshkrime marrëveshjesh online (në këtë rast të dyja palët duhet të nënshkruajnë të njëjtin dokument), tregtinë online (e-commerce) etj.

**12. Pyetje: Pse ka rregullore formale (legjislacion) në këtë fushë kur do të ishte shumë më mirë të lejohej tregu të gjente vetë zgjidhjet?**

Përgjigje: Ka tre faza të përbashkëta për zhvillimin e teknologjive të reja:

- 1) teknologjitë duhet të funksionojnë drejt;
- 2) duhet të jenë të besueshme dhe të lehta në përdorim, dhe
- 3) duhet të jenë të sigurt.

Shembulli më i qartë i kësaj është makina. Vite më parë, prodhuesit mund të tërhiqnin klientët duke thënë së makinat e tyre do të "vazhdonin të ecnin" (makina nuk do të pësonte defekt); dhjetë vjet më parë, kërcënimi ndaj gjobave (= rregullore) ishte mënyra e vetme për t'i bërë njerëzit të përdorin rripat e sigurimit, ndërsa sot, edhe një makinë e vogël duhet të jetë e pajisur me *airbag* për të qënë konkurruese në treg. Prandaj, për sa i përket teknologjive të reja (në këtë rast, nënshkrimet elektronike), rregulloret janë të nevojshme derisa tregu të jetë stabilizuar (faza 3).

**13. Pyetje: Si mund të regjistrohet një ofrues i shërbimit të certifikimit?**

Përgjigje: Nuk ka formular aplikimin zyrtar, por, ekziston një formë për të dhënat personale të kërkuarit. Zgjedhja e formatit për dokumente që vërtetojnë përputhshmërinë e komponentëve teknike dhe konceptin e sigurisë bëhet me anë të një marrëveshje mes kërkuarit dhe organizmit të certifikimit. Hapi i parë përcakton nëse janë plotësuar kërkesat e Ligjit "Për Nënshkrimin Elektronik" dhe rregullores. Përveç këtyre të fundit duhet të plotësohen dhe kërkesat e udhëzuesve të lëshuar nga AKCE ([www.akce.gov.al/informacion](http://www.akce.gov.al/informacion)). Pasi janë hedhur bazat e konceptit mbi sigurinë, kërkuarit (ofruesit e shërbimit të certifikimit) mund të këshillohen me Autoritetin kompetent, veçanërisht me synimin për të kontrolluar përshtatshmërinë e procedurave të ndjekura dhe pastaj të paraqiten pranë autoritetit për tu regjistruar.

**14. Pyetje: A njihen nënshkrimet elektronike të huaja në Shqipëri?**

Përgjigje: Nënshkrimet elektronike dhe produktet e huaja njihen dhe zbatohen në përputhje me aktmarrëveshjet e lidhura nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaja, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave. Por është domosdoshme që ofruesit e huaj të kenë përfaqësuesin e tyre lokal të akredituar sipas ligjeve shqiptare.

**15. Si vepohet me shumën 100 milion që përcaktohet në "Rregullore për nënshkrimin elektronik" si garanci financiare?**

Përgjigje: Në VKM nr. 503, dt. 13.05.2009 përcaktohen mënyrat e garantimit financiar, që arrihen me një depozitë ose garanci bankare, apo police sigurimi pa kusht. Ekziston hapësira e nevojshme që primi i paguar të jetë i vogël, pra i pallogaritshëm në koston e produktit. Për bizneset e mëdha është parashikuar depozita ose garancia bankare, për të tjerat vepohet si në të gjitha rastet e sigurimeve,

merret kuota e produktit në listat standard që kanë shoqëritë e sigurimeve dhe bëhet sigurimi i produktit (software në rastin e certifikatave elektronike).

**16. Pyetje: Çfarë është Direktiva e KE-së mbi nënshkrimet elektronike?**

Përgjigje: Direktiva strukture e KE-së mbi nënshkrimet elektronike hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Komunitetit Evropian (L13/12 e 19 janar 2000). Hartimi i kësaj direktive u bë i nevojshëm pas fillimit të aplikimit të nënshkrimit elektronik në shtetet e BE-së për të siguruar nder-vlefshmërinë mes anëtarëve të komunitetit. Direktiva citon ekuivalencën që ekziston mes nënshkrimit elektronik dhe nënshkrimit dorazi dhe disiplinon e organizon të gjithë ligjet e shteteve komunitare në mënyrë që ato të mos kenë ndryshime substanciale mes tyre, që në kohë mund të bëhen pengesë për shkëmbimet elektronike mes kompanive në shtete të ndryshme.

**17. Pyetje: Një dokument i pajisur me nënshkrim elektronik a ka të njëjtën vlefshmëri ligjore me një dokument të nënshkruar me dorë?**

Përgjigje: Po, tek nenet 4 dhe 5 të ligjit “Për nënshkrimin elektronik” është përcaktuar se, të gjitha transaksionet ligjore që kërkojnë nënshkrimin me dorë si formë ligjore, mund të kryhen në mënyrë elektronike (me nënshkrim të kualifikuar), me përjashtim të fushave ligjore që janë në mënyrë të qartë të identifikuar në një të ashtuquajtur listë negative (p.sh. për të drejtën e trashëgimisë, të drejtën familjare, etj).

**18. Pyetje: Si do mundësohet përdorimi i nënshkrimeve elektronike në komunikimet ndërkombëtare ndërmjet një numri të madh vëndesh kur ekzistojnë shumë zgjidhje të papërputhshme me njëra-tjetrën?**

Përgjigje: Ligji për nënshkrimin elektronik është hartuar në pajtim të plotë me Direktivën evropiane për nënshkrimin elektronik, në strukturën bazë të së cilës janë edhe të gjithë ato të vëndeve anëtare të BE. Në planin afatmesëm, puna jonë do të bazohet krejtësisht në standardet ndërkombëtare dhe specifikimet e ISO / IEC, IETF që sot janë në fuqi. Njohja jonë e shpejtë me aktivitetet e rëndësishme të standardizimit do të thotë që ne jemi në gjendje të përgjigjemi shpejt ndaj zhvillimeve me interes në fushën e ndërveprimit të produkteve në planin ndërkombëtar.

**19. Pyetje: Çfarë e bën kaq të sigurt një nënshkrim që përputhet me kërkesat e ligjit shqiptar “mbi nënshkrimin elektronik”?**

Përgjigje: Ligji “Për Nënshkrimin Elektronik”, Rregullorja dhe dokumente strategjike, lejojnë të operojnë vetëm ato ofrues të shërbimit të certifikimit, siguria e të cilëve është verifikuar, testuar dhe konfirmuar. Gjithë struktura organizative dhe rrjedha e veprimeve të çdo ofruesi të shërbimit të certifikimit, kualifikimet dhe besueshmëria e personelit, madje dhe burimet financiare kontrollohen nga AKCE. Gjithashtu kontrole të mëtejshme, inspektime periodike kryhen çdo vit.

**20. Pyetje: Po në lidhje me hacker-at dhe kodet e crack-uara që kemi dëgjuar shpesh këto kohët e fundit?**

Përgjigje: Në qoftë se ekziston edhe dyshimi më i vogël që një kod mund të jetë i *crack*-uar, ofruesit e shërbimit të certifikimit udhëzohen menjëherë nga Autoriteti të rrisin gjatësinë e paracaktuar të çelësit ose të zëvendësojnë plotësisht algoritmin nga lista e algoritmeve të "përshtatshëm".